



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:281045
Datë: 26.06.2024
Numri i dokumentit: 05861521

C.nr.1971/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses L.S. nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës –Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Vlora Rrahmani, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 982.80 euro, jashtë seance me datë 26.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses L.S. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses së lartcekur, të ia paguajë:

- në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 e deri me datën 21.11.2022, për 306 ditë të pranisë në punë, shumën prej 612.00 euro, dhe
- në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 e deri me datë 21.11.2022, për 306 ditë të pranisë në punë, shumën 342.72 euro,

Të gjitha shumat e lartcekura, në shumë të përgjithshme prej 954.72-€ (nëntëqind e pesëdhjetë e katër euro e shtatëdhjetë e dy cent), detyrohet e paditura që ti paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 20.12.2022 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, në shumën prej 28.08-€.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzetë e katër euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja L.S. nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 20.12.2022, përmes të autorizuarit të saj Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, duke theksuar se paditësja është e punësuar te e paditura në shkollën “Hajdar Dushi” në Gjakovë, e njëjta për periudhën kohore 01.07.2021 e deri me datë 30.11.2022 ka realizuar gjithsej 315 ditë pune. Të njëjtës nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, e as 70% të shpenzimeve të udhëtimit, andaj ka paraqitur padi ku ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëjë pagesën e kompensimit e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e lartcekura në shumë të përgjithshme prej 982.80 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Vlora Rrahmani, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 17.05.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se sipas kontratës së punës askund nuk është cekur se paditëses i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit në punë, të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takojnë kompensimet e tilla, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënësi i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënësi që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, ndërsa vërtetimet nuk qartësojnë çështjen e konkretizimit sa i përket ditëve të punës, duke theksuar se dita e plotë e punës është 8 orë pune dhe nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 orëve punë aktive në shkollë. Kontrata Kolektive parasheh mundësinë e punëtorëve që të kenë edhe ndonjë vend tjetër të punës andaj kompensimi është i lidhur me një punë të përcaktuar e cila llogaritet si punë primare, mbi këtë bazë mungojnë dëshmitë nga Administrata Tatimore që konfirmon faktin që paditësja nuk është i angazhuar edhe në ndonjë punë tjetër. Po ashtu sa i përket shujtave, duhet të ketë domosdoshmërisht dëshmi nga institucioni përkatës se nuk është e rregulluar forma e ushqimit brenda institucionit dhe që nuk paguhet ndonjë shtesë për shujtë nga punëdhënësi. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës

administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se paditësja L.S. është e punësuar si mësimdhënëse e lëndës së Tik-ut, te e paditura në gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë, gjatë periudhës 01.07.2021 e deri me datë 30.11.2022 paditësja ka punuar gjithsej 315 ditë pune, fakte të vërtetuara përmes Kontratës së Punës në versionin e fotokopjuar e lëshuar nga e paditura Komuna e Gjakovës dhe Vërtetimit mbi përvojën e punës me nr.2708 i datës 07.12.2022 i lëshuar nga gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë.. Meqenëse paditësja banon në Gjakovë në rrugën “Vëllëzërit Kajtazi” nr. 49, fakt i vërtetuar nga Certifikata e vendbanimit me numër serik B 10492647 për paditësen, e njëjta ka udhëtuar për në vendin e punës duke paguar biletën e udhëtimit për në gjimnazin “Hajdar Dushi”, në shumën prej 0.80 euro për një drejtim, fakt i vërtetuar nga kuponi fiskalë me numër 600073001. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK-së, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’u bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është në tërësi e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, të njëjtës ia njohi shumën në vlerë prej 612.00 euro. Ndërsa sa i përket kërkesës së dytë, lidhur me shpenzimet e udhëtimit, gjykata aplikoi nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit ku është përcaktuar se *“punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, ashtu që pasi vërtetoi çmimet e biletave si më sipër, për 306 ditë të pranisë në punë, paditëses në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit ia njohi shumën prej 342.72 euro.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata analizoi edhe pretendimin e të paditurës se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 orëve punë aktive në shkollë, mirëpo gjykata ditët e pranisë në punë i ka vërtetuar përmes Vërtetimit të lëshuara nga shkolla përkatëse ku punon paditësja dhe të njëjtave iu fali besimin pasi që janë të hartuara në formën e caktuar nga organi përkatës brenda kufijve të kompetencës së tij.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se paditësja nuk ka ofruar prova sa i përket faktit nëse është e punësuar edhe në ndonjë punë tjetër, si dhe nuk ka ofruar prova nga institucioni përkatës se a e ka të rregulluar formën e ushqimit brenda institucionit, gjykata vë në dukje se bazuar në nenin 7 par.1 të LPK-së është përcaktuar se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*, andaj meqenëse e paditura nuk ka ofruar prova materiale përmes të cilave mbështeten pretendimet e lartcekura, andaj gjykata të njëjta i refuzoi si të pabazuara.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, e njëjta ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësja ka kërkuar që të i kompensohen shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për periudhën kohore 01.07.2021 e deri me datë 30.11.2022. ndërsa padinë e ka

paraqitur me 20.12.2022, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit ligjor të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të iu kompensuar kompensimi në emër të ushqimit dhe udhëtimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarit. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej t'a përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e tyre në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësja.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e refuzoi kërkesën e paditëses për periudhën kohore prej datës 22.11.2022 deri me datë 30.11.2020, pasi që gjykata vë në dukje që Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 21.01.2021 ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, kur edhe është shkëputur nga njëra palë kontraktuese dhe atë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me njoftimin e datës 21.11.2022, andaj kjo kontratë kolektive nuk prodhon efekt juridik pas datës së lartcekur, për çka gjykata nuk ia njohi këtë kompensim paditëses për periudhën e lartcekur, përkatësisht për 9 ditë pune të paditëses, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Për shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata vendosi sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 104.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 134.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1971/22, me datë 26.06.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën